



Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Predato Received / Delivery	01.11.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstva Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SKANSHICK	6801/2023		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1165/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë të ankesës me numër A.nr.1165/2023, të datës 15.09.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike „kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.1165/2023, e datës 15.09.2023, e parashtruar nga ankues.

A r s y e t i m

Ankuesi (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 15.09.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të punës (shujtës), sipas Vendimit me numër 01-110/01-206963/22 të datës 26.09.2022, të Kuvendit Komunal të Komunës së Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tani e tutje Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 23.10.2023, ka përcjellë shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6099/2023 të datës 15.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit me numër 03-615/03-156974/23 të datës 31.07.2023 e parashtruar tek Komuna e Prishtinës; Kërkesën e ankuesit me numër 14-070/01-

0132305/23 të datës 6.06.2023 e parashtruar tek kabineti i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Vendimin me Nr.Prot.2126-1/2022 të datës 13.10.2022 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Vërtetimin me numër 01 nr.119-1075 të datës 17.11.2022 nga UD. Menaxheri i Personelit të Komunës së Prishtinës lidhur me përvojën e punës së ankuesit; Akt emërimit e ankuesit me numër 01 nr.112-1075 të datës 11.11.2019; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Vendimin me numër 01-110/01-206963/22 të datës 26.09.2022 për financimin e shujtave ditore për shërbyesit civil në Komunën e Prishtinës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 19.09.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 23.10.2023 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës dhe atë Njoftimin në lidhje me kërkesën e datës 03.08.2023 nga Komuna e Prishtinës; Kërkesën e ankuesit me numër 14-070/01-132305/23 të datës 26.06.2022 e parashtruar tek Komuna e Prishtinës; Vërtetimin me numër 01 nr.119-1075 të datës 17.11.2022 nga U.D. Menaxheri i Personelit për ankuesin; Akt emërimit e ankuesit me numër 01 nr.112-1075 të datës 11.11.2019 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit me numër A.nr.1165/2023 e datës 15.9.2023, është e jashtëafatshme **sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se ankuesi Hyzri Bunjaku është i punësuar në Komunën e Prishtinës, rrjedhimisht i njëjti sipas Akt emërimit me numër 01 nr.112-1075 të datës 11.11.2019, ushtron pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit të Sportit*, në Departamentin/Drejtorinë e Sportit. I njëjti më datë 26.06.2023 përmes kërkesës me numër 14-070/01-132305/23, i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, me kërkesën për kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të punës (shujtës), sipas Vendimit me numër 01-110/01-206963/22 të datës 26.09.2022, të Kuvendit Komunal të Komunës së Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit me datë 03.08.2023 në përgjigje të kërkesës së ankuesit të datës 26.06.2023, ka njoftuar të njëjtin së Njësia e Burimeve Njerëzore nuk është kompetent për zbatimin e Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr.01-110/01-206963/23 të datës 26.09.2022.

Më tej nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi me datën 31.07.2023 përmes shkresës me numër 03-615/03-156974/23, ka parashtruar ankesë tek Komisioni për Ankesa në Komunën e Prishtinës po me bazë të njëjtë ankimore rrejdhimisht për njohje të së drejtës në kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të punës (shujtës), ndërsa, ankuesi me datë 15.09.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, duke kërkuar po ashtu kompensimin e shujtës ditore në vlerë prej pesë eurove në ditë, gjithsej në vlerë prej 1.000 eurove, mbi bazën e Vendimit Nr.01-110/01-206963/23 të datës 26.09.2022, të Kuvendit Komunal të Komunës së Prishtinës.

Në kuptim të përmbushjes së kërkesave lidhur me pranueshmërinë e ankesës, Kolegji i ‘u referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 129 me të cilin përshihet se: *1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj, si dhe nenit 127 paragrafi 1 të të njëjtit ligj me të cilin përcaktohet se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ...”*. rrejdhimisht, në këtë kontekst ligjor, Kolegji bazuar në provat materiale të kësaj çështje administrative ka konstatuar se vendimi mbi bazën e të cilit ankuesi ka ngritur pretendimin ankimor ka njohur të drejtën në realizmin e shujtave ditore për

shërbyesit civil në Komunën e Prishtinës për vitin 2022, në shumën prej 5 eurove në ditë dhe se i njëjti ka hyrë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në web faqen e Komunës së Prishtinës (pra me datë 12.10.2022), ndërsa, ankuesi deri me datë 26.06.2023 nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik në kuptim të realizimit të së drejtës për kompensimin e shujtës ditores sipas këtij vendimi, përkatësisht ankuesi deri me datë 15.09.2023 (data e parashtrimit të ankesës në Këshill) nuk ka ndërmarrë asnjë mjet juridik në kuptim të kundërshtimit të mos realizimit të kompensimit të shujtës ditore sipas Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr.01-110/01-206963/23 të datës 26.09.2022, kështu që nisur nga këto fakte, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill më datë 15.09.2023, është e papranueshme pasi që është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 129 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Theksuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVË

Lënda me numër A.nr.1165/2023.

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

